

VENDIM
Nr. 311, datë 27.5.2021

**PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE TË PROCEDURËS PËR
PËRZGJEDHJEN E KËSHILLTARËVE TË BORXHIT SHTETËROR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të paragrafit të parë, të nenit 31, të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, "Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e procedurës që do të ndiqet për procesin e për zgjedhjes së këshilltarëve të borxhit shtetëror, në përputhje me parimin e konkurrencës, të mosdiskriminimit, të transparencës, të trajtimit të barabartë të ofertuesve, duke ruajtur konfidencialitetin e sekretin tregtar të subjekteve.

2. Përzgjedhja e këshilltarëve të borxhit shtetëror, duke përfshirë këtu edhe këshilltarin ligjor për Eurobondin, bëhet nga ministria përgjegjëse për financat me anë të procedurës së shpalljes publike.

3. Ministri përgjegjës për financat, me urdhër të veçantë, përcakton grupin e punës, jo më pak se 3 (tre) persona, specialistë të fushës, për përgatitjen e dokumentacionit për shpalljen e ftesës për ofertë, i cili është përgjegjës për:

- a) hartimin e specifikimeve teknike/termave të referencës;
- b) përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës;
- c) hartimin e ftesës për propozimin teknik dhe financiar.

4. Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës mund të bëhet duke u bazuar në:

- a) çmimet e tregut; ose/dhe
- b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë autoriteti kontraktor.

5. Në ftesën për propozimin teknik dhe financiar duhet të përcaktohen:

- a) qëllimi i emërimit të këshilltarit;
- b) shërbimi, që kërkohet të merret nga këshilltari;
- c) udhëzimet për operatorët ekonomikë;
- ç) kriteret e për zgjedhjes;
- d) afati i paraqitjes së propozimeve;
- dh) data, ora dhe vendi i paraqitjes së propozimeve;
- e) kriteret e vlerësimit;
- ë) sigurimi i ofertës në vlerën 2% të fondit limit të kontratës;
- f) çdo element tjetër i vlerësuar si i nevojshëm.

6. Grupi i punës publikon ftesën për propozimin teknik dhe financiar në faqen zyrtare të institucionit, në adresën: www.financa.gov.al.

7. Çdo operator ekonomik mund të dorëzojë një kërkesë për pjesëmarrje në përgjigje të njoftimit që përmban informacionin e përcaktuar në ftesën për ofertë.

7.1 Afati kohor minimal për marrjen e kërkesave për pjesëmarrje është jo më pak se 20 (njëzet) ditë kalendarike nga data në të cilën është publikuar njoftimi.

8. Në rast se përpara përfundimit të afatit të dorëzimit të propozimeve ofertuesit e interesuar kërkojnë shtyrjen e këtij afati, ministri, pas shqyrtimit të kërkesës dhe arsyeve përkatëse, vendos pranimin ose refuzimin e saj. Vendimi për shtyrjen e afatit publikohet në faqen zyrtare të internetit të ministrisë përgjegjëse për financat.

9. Ministri, me shpalljen e ftesës për ofertë, nxjerr urdhrin për përcaktimin e anëtarëve të Komisionit për Vlerësimin e Ofertave, këtu e në vijim "Komisioni".

9.1 Komisioni përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) persona, specialistë të fushës, ky i fundit është përgjegjës për shqyrtimin e ofertave të paraqitura. Në çdo rast, numri i anëtarëve duhet të jetë tek.

9.2 Nuk mund të marrin pjesë në këtë komision personat që kanë konflikt interesi me aplikuesit, sipas kuptimit të ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”. Anëtarët e komisionit kanë detyrimin të ruajnë konfidencialitetin e përmbajtjes së aplikimeve.

10. Pas dorëzimit zyrtar të propozimeve nga ofertuesit e interesuar në protokollin e ministrisë përgjegjëse për financat, sipas përcaktimeve të ftesës për ofertë, komisioni fillon vlerësimin e tyre. Afati për kryerjen e vlerësimeve është brenda 7 (shtatë) ditëve kalendarike, nga data e përfundimit të afatit për dorëzimin e propozimeve. Në varësi të analizave paraprake të propozimeve, në rast se komisioni e gjykon të arsyeshme, mund t’u kërkojë ofertuesve propozues të dërgojnë sqarime dhe informacion shtesë, duke u caktuar edhe afatin e paraqitjes së tyre. Në këtë rast, afati i vlerësimit shtyhet me 5 (pesë) ditë pune nga data e paraqitjes së sqarimeve shtesë.

10.1 Çdo ofertë e dorëzuar pas afatit të përcaktuar në ftesën për ofertë nuk shqyrtohet nga komisioni dhe i kthehet e pahapur ofertuesit.

10.2 Komisioni vazhdon procedurën e vlerësimit edhe në rast se paraqitet 1 (një) ofertues i vetëm.

10.3 Në rast se nuk paraqitet asnjë ofertë, komisioni anulon procedurën.

11. Vlerësimi i propozimeve kryhet për ofertën më të mirë bazuar në çmimin dhe propozimin teknik, duke u mbështetur në:

- a) eksperiencën e ofertuesit në dhënien e shërbimeve të ngjashme;
- b) kapacitetin teknik për ofrimin e shërbimit të kërkuar;
- c) ofertën ekonomike.

11.1 Ofertat e paraqitura nuk duhet të ndryshohen në asnjë rast.

11.2 Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korrigjohen në mënyrën e mëposhtme:

- Nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij;

- Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet fjalëve dhe shifrave, mbizotëron shuma në fjalë.

Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se $\pm 2\%$ e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar.

12. Pas përfundimit të vlerësimit, komisioni harton procesverbalin e vlerësimit ku rendit ofertuesit e skualifikuar me arsyet përkatëse dhe ofertuesit e kualifikuar me pikët totale sipas renditjes përfundimtare.

12.1 Në përfundim të fazës së vlerësimit, komisioni përgatit një raport përmbledhës, ku renditen ofertuesit pjesëmarrës në procedurë, ofertuesit e skualifikuar me arsyet përkatëse, si dhe renditja sipas pikëve totale të ofertuesve të kualifikuar, të cilin ia dërgon për miratim ministrit.

13. Ministri, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike, nga paraqitja e raportit përmbledhës nga komisioni, vendos të miratojë ose të refuzojë shpalljen e fituesit, apo të anulojë dhe të përsërisë procedurën.

14. Shpallja e fituesit ose anulimi i procedurës publikohen në faqen zyrtare të internetit të ministrisë përgjegjëse për financat.

15. Ankesa/at e ofertuesit/ve ndaj procedurës së zhvilluar i paraqiten ministrit, brenda 5 (pesë) ditëve pune, nga dita e nesërme e shpalljes së njoftimit.

15.1 Ministri ia ngarkon për shqyrtim ankesën/at një komisioni të përbërë nga 3 (tre) persona ekspertë të fushës për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim. Përjashtimisht, në rast të mungesës së personelit, ministri ia ngarkon çështjen për shqyrtim 1 (një) zyrtari të vetëm, i cili duhet të jetë ekspert fushe. Komisioni/zyrtari i ngarkuar është përgjegjës për vendimin e dhënë në përfundim të shqyrtimit të ankesës.

15.2 Anëtarët e komisionit/zyrtari i ngarkuar nuk duhet të kenë marrë pjesë në marrjen e vendimit, për të cilin është paraqitur ankesa.

15.3 Vendimi duhet të merret brenda 5 (pesë) ditëve pune, nga data e paraqitjes së ankesës dhe është përfundimtar.

16. Ministri, pas përfundimit të afatit të ankimit, negocion dhe nënshkruan kontratën me ofertuesin fitues, e cila përmban, ndërmjet të tjerash, termat kryesorë të ofrimit të shërbimit, si dhe sigurimin e kontratës në vlerën 10% të kontratës.

16.1 Kur fituesi nuk arrin të nënshkruajë kontratën ose nuk arrin të bëjë sigurimin e kontratës, autoriteti kontraktor fton për lidhjen e kontratës ofertuesin vijues në klasifikimin e ofertuesve.

17. Efektet financiare, për zbatimin e këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i ministrisë përgjegjëse për financat.

18. Vendimi nr. 201, datë 5.3.2020, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kushteve dhe të procedurës për përzgjedhjen e këshilltarit financiar për menaxhimin e borxhit shtetëror”, shfuqizohet.

19. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama